

URDHËR
Nr. 318, datë 26.3.2026

**PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENET E PRESPËS, FIERZËS, ULZËS
DHE SHKOPETIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin të të gjitha llojeve të peshqve në liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit, konkretisht:

- a) Për gjuhçën (cironka) – *Alburnus Albidus Alborella*, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2026;
- b) Për krapin – *Cyprinus Carpio*, prej 25 prillit deri më 25 maj 2026.

2. Për periudhën 25.4.2026 deri më 25.6.2026, ndalohet peshkimi me rrjeta në fashën bregliqenore prej 150 ml nga bregu për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të përkatëse.

4. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në koordinim me OMP-të përkatëse që ushtrojnë aktivitete peshkimi në këto liqene.

5. OMP-të të marrin të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve, ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në këto liqene.

6. OMP-të bashkëpunojnë me strukturat e vetëqeverisjes vendore, drejtoritë rajonale të AKU-së, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare të qarqeve përkatëse dhe me policitë bashkiake përkatëse.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqeneve të Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla